



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rregullorja për Botim e Kolegjit BIZNESI është hartuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, në Statutin e Kolegjit neni 81; në Rregullore e brendshme e Kolegjit BIZNESI, kreu 8 dhe neni 65.; si dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe që është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor datë 27.09.2019, të Kolegjit BIZNESI.

RREGULLORJA PËR BOTIM

Neni 1

Fushë veprimi i Rregullores

1.1.Fushëveprimi i veprimtarisë botuese rregullohet përmes kësaj rregullore.

Neni 2

Shtëpia Botuese Kolegji Biznesi shpall konkurs të hapur për dorëzimin e punimeve shkencore dhe librave shkencore.

2.1. Afati për botim i punimeve shkencore shpallet nga fillimi i vitit akademik dhe duhet të finalizohet deri në semestrin e dytë të vitit akademik.

2.2. Përderisa afati për botim i librave shkencore dhe llojet tjera të botimeve, afati për dorëzim të dorëshkrimeve mund të bëhet gjatë gjithë vitit akademik .

Neni 3

E Drejta e Botimit

Të drejtë botimi kanë :

- Staf akademik
- Bashkëpunëtorët e Kolegjit
- Punime të përbashkëta profesor –student
- Hulumtuesit e pavarur
- Studentet e kolegjit dhe student tjerë nga universitetet publike dhe kolegjet si dhe studentet ndërkombëtar
- Hulumtuesit ndërkombëtar

Neni 4

4.1 Punimet shkencore dhe librat e gatshme për botim duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara teknike (kolegji ka kriteret dhe duhet të vendosin këtu)

Neni 5

Punimet dhe librat të dorëzuar për botim në “Shtepin Botuese” të Kolegji Biznesi duhet të jenë origjinale ,

5.1 Para botimit duhet të nënshkruhet deklarata se punimi apo libri është origjinal.

5.2.Para se të botohet punimi do të kontrollohet përmes softveri për të iu shmang plagjiaturës.

Neni 6

Komisioni Vlerësues

6.1.Për vlerësimin e punimeve dhe librave shkencor dhe librave tjerë themelohet komisioni vlerësues i përbër nga kryetari dhe dy anëtar.

6.2. Komisioni nxjerr vendim nëse nga tre anëtar dy anëtar të Komisionit Vlerësues japin mendim pozitivë për kriteret e plotësuar për botim.

6.3.Komisioni në periudhën prej 14 ditë pas mbylljes së konkursit nxjerr vendim për botim ose mosbotim të punimeve individuale apo të përbashkëta.

6. Në kuadër të punimit shkencor dhe librave mund të jenë dy ose më shumë autorë .

Neni 7

Procedura e dorëzimit të punimeve dhe librat shkencore

7.1.Punimet shkencore në versionin përfundimtar duhet të dorëzohet në word ose PDF dhe në mënyrë elektronike

7.2.Libri shkencor dorëzohet në versionin përfundimtar në word /PDF

7.3.Punimë tjera dorëzohen në versionin në Word /PDF dhe në mënyrë elektronike

Neni 8

8.1.Të gjitha punimet financohen nga Kolegji Biznesi

8.2.Punimet mund të botohen edhe përmes donatoreve.

Neni 9

9.1 Shtëpia Botuese “Kolegji Biznesi” krijon marrëveshje bashkëpunimi me universitetet publike, kolegjet si dhe universitetet ndërkombëtare për botime të përbashkëta.

Neni 10

10.1.Rregullorja hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Dekani i Kolegjit Biznesi.

Prishtinë me ___/___/2019

KLMSH i "BIZNESI" –Prishtinë
Dekani

Prof. dr. Shyqeri Kabashi/